



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.6/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga A.Zh.D., M.B., N.J.P., Sh.K. dhe A.M.H., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, D.K., lidhur me vendosjen në lëndën C.nr.2103/22, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 23.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga A.Zh.D., M.B., N.J.P., Sh.K. dhe A.M.H., ndaj gjyqtarit tani të Gjykatës së Apelit të Kosovës, D.K., lidhur me vendosjen e tij në lëndën C.nr.2103/22, derisa ishte gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 15.07.2024, Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e A.Zh.D., M.B., N.J.P., Sh.K. dhe A.M.H.. Në ankesë i njëjti ka pretenduar se gjyqtari D.K. duke vepruar në rishqyrtim dhe rivendosje, ka nxjerr aktgjykimin C.nr.2103/22 të datës 29.11.2023, përmes të cilit është vendosur që të refuzohet e pabazuar kërkesë padia e paditësve A.Zh.D., M.B., N.J.P., Sh.K. dhe A.M.H., me të cilën kanë kërkuar të “anulohet konkursi i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë me Nr.Ref.MSH-006/03/17 i datës 29.11.2023, për Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare dhe të obligohet e paditura që të themelojë marrëdhënie pune me të paditurat”. Tutje kanë theksuar se gjyqtari duke vendosur në rigjykim dhe rivendosje nuk i’u ka përmbajtur vërejtjeve dhe rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë dhe i njëjti fare nuk e ka trajtuar çështjen e interesit juridik e cila ishte arsyeja e vetme për të cilën kjo çështje ishte kthyer nga gjykata e shkallës së dytë në rigjykim dhe rivendosje mirëpo subjekti i ankesës vetëm ka vendosur që të refuzojë kërkesëpadinë duke ndryshuar tërësisht qasjen ndaj lëndës. Kanë shtuar se vlerësojnë se gjyqtari ka konsumuar shkelje disiplinore në lëndën kontestimore C.nr.2103/22, në atë mënyrë që ka nxjerr aktgjykimin C.nr.2103/22, të datës 29.11.2023 në kundërshtim me vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit përmes aktgjykimit Ac.nr.931/2020, të datës 26.04.2020.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 29.07.2024, përmes aktpërcjellësit ADGJA.nr.5/2024 të datës 29.07.2024, e ka dërguar lëndën në Gjykatën Themelore

në Prishtinë për vendosje me arsytimin se pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore i referohen aktgjykimit C.nr.2103/22, të datës 29.11.2023, të cilin gjyqtari D.K. e ka nxjerr në kohën sa ka qenë gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë Albina Shabani Rama përmes aktpërcjellësit GJ.A.Su.A.nr.688/24, të datës 12.08.2024, e kthen lëndën në Gjykatën e Apelit për vendosje.

Kryetari i Gjykatës me datë 16.08.2024, nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankueset A.Zh.D., M.B., N.J.P., Sh.K. dhe A.M.H..

Gjyqtari D.K., ka dhënë deklaratë me datën 19.08.2024, ku ka theksuar se në gjykimin sipas padisë datë 28.10.2019, është marrë vendim për aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë, të anulohet konkursi, kurse është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë me të cilën paditëset kanë kërkuar që të obligohet e paditura që të themelojë marrëdhënie pune me të njëjtat. Gjykata e Apelit këtë lëndë e kishte kthyer në rivendosje sipas vendimit Ac.nr.931/2020. Duke vepruar në seancë të rigjykimit, sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, është marrë vendim të refuzohet kërkesëpadia. Ka shtuar se një pjesë e ankesës së palëve ankuese është se pse është vendosur ndryshe në seancë të rigjykimit mirëpo kjo mënyrë e vendosjes ka rrjedhë si rezultat i vlerësimit të provave që kanë ofruar ndërgjyqësit si dhe vlerësimit të tyre, po ashtu vendimit të Gjykatës së Apelit. Përmes aktgjykimit me të cilën është refuzuar kërkesëpadia, janë ofruar edhe arsye se pse gjykata ka vlerësuar në mënyrë të ndryshme provat dhe ka ndryshuar vendimmarrja. Është mirëfilli e njohur se nëse lënda kthehet në tërësi në rigjykim, vendimmarrja nuk do të jetë e kushtëzuar nga gjykimi që është bërë më parë. Tutje ka theksuar se ankesa e paditëseve për masë disiplinore, në masë të theksuar përmban pretendime lidhur me meritat e kontestit.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit D.K., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit A.Zh.D., M.B., N.J.P., Sh.K.
dhe A.M.H., është **e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratës së gjyqtarit, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritator, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrihen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtojë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës së Apelit.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtari D.K. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
ADGJA.nr.6/2024, me datë 23.08.2024

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit D.K.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,